

GJYKATA KOMUNALE NË DRAGASH, si Gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi, në çështjen juridike të paditësit **KEK-u Distrikti në Prizren, të cilën e përfaqëson i autorizuari B. P., kundër të paditurit Z. M. nga fsh..., Komuna e Dragashit me vendbanim në Prizren Rr...,m nr...,** lidhur me kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 510,13 €, në shqyrtimin përfundimtarë të mbajtur me dt. 01.12.2011, në prezencën e të autorizuarit të paditësit e në mungesë të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesë padia e paditësit **KEK-u** – Divizioni i furnizimit në Prizren .

II. OBLIGOHET i padituri **Z. M. nga fsh..., Komuna e Dragashit,** tani me vendbanim në Prizren ,që paditësit të i kompensoj dëmin e shkaktuar për shfrytëzimin e pa-autorizuar të energjisë elektrike ,në shumë prej 510,13 €, me kamat ligjore prej 3% dhe atë që nga data 01.12.2010 deri në pagimin përfundimtarë, të gjitha këto i padituri duhet të i paguaj brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .

III. Me shpenzimet e procedurës OBLIGOHET e paditura që paditësit të i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 38.00 euro të gjitha këto në afta prej 15..ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi në të dhënat e cekura në padi, dhe nëpërmjet përfaqësuesit të saj gjatë shqyrtimeve të mbajtura i propozon gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të aprovoj këtë kërkesë padi si të bazuar dhe të paditurin ta obligoj që të i kompensoj dëmin në shumë prej 510,13 € me kamat ligjore si dhe shpenzimet procedurale. Përfaqësuesi i paditësit **B. P.** në vazhdim e arsyeton kërkesë padinë në rrethanat se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes nga neni 252. par. 1. të KPK-së Aktgjykimi P.nr. 99/05 të dt. 16.11.2006 e i cili Aktgjykim është i plotfuqishëm që nga data 21.12.2006 , dhe se i padituri i ka shkaktuar dëm KEK-ut Divizioni i furnizimit në Prizren për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes dhe atë në vlerë prej 510,13 € e të cilin dëm nuk ia ka kompensuar paditësit.

Shqyrtimin gjyqësor të dt. 01.12.2011 gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurit **Z. M.** e i cili edhe pse ka qenë i thirrur në mënyrë të rregullt mungesën e tij nuk e ka

arsyetuar, njëherit i autorizuari i paditësit ka propozuar mbajtjen e shqyrtimin në mungesë të paditurit dhe se gjykata ka vepruar konformë dispozitave ligjore të parapara në nenin 423. par. 3. të LPK-së, ku e njëjta këtë shqyrtim e ka mbajtur në mungesë të paditurit.

Edhe pse gjykata shqyrtimin e ka mbajtur në mungesë të paditurit në këtë çështje juridike ka bërë administrimin e këtyre provave: është lexuar Aktgjykimi P.nr. 99/05 i dt. 16.11.2006 të lëshuar nga ana e Gjykatës Komunale në Dragash i cili është bërë i plotfuqishëm me dt. 21.12.2006, është lexuar fatura me nr. 136/2005 e dt. 25.04.2005 , është lexuar procesverbalit për kontrollin e instalimit elektrik i dt. 21.04.2005 ku është vërtetuar që njehsori elektrik është keqpërdorur dhe është bërë shfrytëzimi i rrymës elektrike në mënyrë të pa-autorizuar, është lexuar formulari i transaksionit të konsumatorit ID nr....., të dt. 04.11.2011 në emër të Z. M. ku është vërtetuar adresa e saktë e të paditurit dhe rryma e harxhuar .

Pra nga vlerësimi i këtyre provave që janë administruar veç e veç dhe në lidhshmëri me provat tjera , a në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjykata ka gjetur se kërkesë padia e paditësit është e bazuar nga këto arsye :

Në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës komunale në Dragash P.nr. 99/05 i dt. 16.11.2006 i cili është bërë i plotfuqishëm me dt. 21.12.2006 është vërtetuar fakti se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes nga neni 252. par. 1. të KPK-së dhe ndaj tij gjykata ka shqiptuar **vërejtje gjyqësore** dhe të dëmtuarin KEK-u – Distrikti në Prizren për realizimin e kërkesës pronësore – juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Nga faturimi nr. 136/2005 e dt. 25.04.2005 i energjisë elektrike të shpenzuar në mënyrë të pa autorizuar është vërtetuar se i padituri i ka shkaktuar dëm paditësit në shumë prej 510,13 €, e cila llogaritje është bërë në bazë të procedurës të shërbimit të kontrollit –procesverbalit nr. 1063 të datës 21.04.2005 .

Në bazë të procesverbalit për kontrollin e instalimit elektrik i dt. 21.04.2005 është vërtetuar që njehsori elektrik është keqpërdorur duke përdorur njehsorin elektrik me të cilin në mes të xhamit dhe pjesës metalike depërton shiriti filmik apo gjësende të tjera dhe është bërë shfrytëzimi i rrymës elektrike në mënyrë të pa-autorizuar, si dhe në bazë të formularit të transaksionit të konsumatorit ID nr....., të dt. 04.11.2011 në emër të Z. M. është vërtetuar adresa e saktë e të paditurit dhe rryma elektrike e harxhuar nga viti 2002 deri në muajin tetor të vitit 2011 .

Nga ajo që u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 151 par.1 pika. a të LPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës- taksës gjyqësore për padi prej 38,00 euro është marrë në kuptim të dispozitave nga neni 452. të LPK-së.

GJYKATA KOMUNALE NË DRAGASH
C.nr. 102/08 të dt. 01.12.2011

Gj y q t a r i :
Sabaheta Kurteshi

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Qarkut në Prizren brenda 15 dite nga dita e pranimet. Ankesa dorzohet në këtë gjykatë.